



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

Elbasan më _____,_____,2026

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PROÇES-VERBAL PËR HARTIMIN E KRITEREVE

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Rikonstruksion godina Qendrës Sociale “Balashe”, me fond limit 137.729.941 (njëqind e tridhjetë e shtatëmilion e shtatëqind e njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e dyzet e një) lekë pa t.v.sh.

- **KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Kodi CPV: 45210000-2 - Punime ndërtimi**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Bashkia Elbasan, ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;

- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme përvërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një Bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit/entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Kriteret e përgjithshme përmbajne listën e dokumentacionit, ligjor dhe administrativ, të kandidatëve/ofertuesve, që duhet të plotësojnë për të marrë pjesë në procesin e prokurimit, në përputhje me nenin 76 dhe 77 të LPP-së, nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Kriteret e përgjithshme për pranimin e operatorëve pjesëmarrës janë të pandryshueshme dhe janë vënë të njëjta me Dokumentet Standarde të Tenderit sipas Vendimit Nr. 10, Datë 23.09.2024 te miratuara nga APP.

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Kriteri (1- a) është vendosur në bazë. bazohet në nenet 76, 77 dhe 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, si dhe nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 82 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar percaktohet:

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari percaktohet në rregullat e prokurimit publik.

Kriteri (1-b) është vendosur bazuar në nenin 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe nenin 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Në piken 1 të nenit 83 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe piken 1 të nenit 30 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar percaktohet: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: Sipas Shtojcës 7.

2.1.1 Operatori ekonomik duhet te kete paguar **taksat dhe tarifate vendore për vitin 2026 (këstet e maturuara)** ose taksat dhe tarifate vendore per vitin **2025** per ato bashki te cilat me vendim te keshillit bashkiak, afati per pagimin e taksave dhe tarifave vendore (kestet e maturuara) eshte pertej dates se zhvillimit te procedures, te percaktuar ne njoftim e kontrates. Pagesa e taksave dhe tarifave vendore duhet te behet për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifate vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin Publik”, i ndryshuar; ligjin nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, si dhe në ligjin Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5. Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vertetuar qe operatorët ekonomikë nuk kane pagesa te pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

Ne nenin 76, pika 2 të LPP parashikohet: Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në nenin 43 të ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia.

Ne nenin 2, germa ç, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet: Ky ligj zbatohet për:

ç) sistemin e tatimeve, taksave dhe tarifave vendore, për aq sa nuk rregullohen me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar.

Ne nenin 4, pika 1 dhe 3, te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimet dhe taksat janë kombëtare ose vendore.

3. Tatimet dhe taksat vendore përcaktohen në ligjin për sistemin e taksave vendore.

Ne neni 43 te ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise”, i ndryshuar, parashikohet:

1. Tatimpaguesi, person fizik dhe juridik, regjistron çdo ndryshim të të dhënave në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, siç përcaktohet në ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

1/1. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend. Për hapjen e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, tatimpaguesi pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm. Kjo certifikatë lëshohet për të identifikuar vendndodhjen e ushtrimit të veprimtarisë, kur është e ndryshme nga selia.

1/2. Edhe personi fizik tregtar i pajisur me NIPT/NUIS, për çdo veprimtari të re që kërkontë regjistrojë, pajiset me një certifikatë, me numër unik identifikimi të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes të veprimtarisë së re.

Ne nenin 5 të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet: Me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet shprehimisht ndryshe, bashkia, nëpërmjet këshillit bashkiak:

a) bën edhe kategorizime më të hollësishme, në përputhje me kushtet dhe interesat vendorë, brenda kategorive minimale të bazës së taksës, të përcaktuar në këtë ligj;

b) vendos për nivelin e taksës, brenda kufijve të përcaktuar në këtë ligj, për çdo kategori nënkategori të bazës së taksës;

c) përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit që prokurohet. Kërkesa konsiderohet e përmbushur, nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 dhe 3, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe në proporcion me vlerën e fondit limit të kësaj procedure.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare.

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:

a) dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;

b) vlerën e përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Sa mesiper, duke qene se lloji i procedures eshte e hapur, eshte kerkuar qe vlera minimale e xhiros vjetore per tu permbushuar nga operatorët ekonomikë te jete sa fondi limit.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve ne perputhje me Ligjin nr.10091, date 05.03.2009 "Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit te ekspertit kontabel te regjistruar dhe te kontabilistit te miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur bazuar në Nenin 77, te ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 43, pika 4 te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar; si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41.

Në nenin 77, pika 1 dhe 3, e LPP parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Ne nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nder te tjera parashikohet:

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen bilance të tre viteve të fundit, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar ligjit nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Ne nenin 61 të Ligjit Nr. 29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore" parashikohet:

1. Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjithatë ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor.

2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

5. Mënyra e deklarimit, përfshirë deklarimin elektronik, dhe formularët përkatës të deklarimit, paraqiten sipas përcaktimeve në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji. **Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.**

Ne nenin 41 të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar përcaktohet se:

Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre:

a) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike me interes publik;

b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:

i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh;

ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh;

iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit (sipas shtojcës 9) i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: - Kontratë punimesh, -Situacionin përfundimtar, -Akt-kolaudimin, -Çertifikatën e marrjes në dorëzim, -Faturat tatimore të deklaruara në organet tatimore.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruara në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën bazë ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor/Investitorit, si dhe Miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor/investitorit.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën. Në nenin 77, pika 4 i LPP, ndër të tjera parashikohet se: Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, prandaj bazuar edhe në nenin 39, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më të vogël se dyfishi i vlerës limit të objektit të prokurimit për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Kërkesa se për kontratat e realizuara si nënkontraktor, duhet të paraqitet kontrata baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor/Investitorit, si dhe Miratimi zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor/investitorit, bazohet në nenin 127 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, si dhe dispozitat e kodit civil, neni 857. Në nenin 127 të LPP, pika 3 parashikohet se: Autoriteti ose entë kontraktor miraton nënkontraktorët e mundshëm përpara lidhjes së nënkontratës me operatorin ekonomik fitues të kontratës publike, në përputhje me dispozitat

e këtij ligji, pa cenuar parimet e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni. Në nenin 857 të Kodit Civil parashikohet se: Sipërmarrësi nuk mund të japë me nënsipërmarrje kryerjen e veprës ose kryerjen e shërbimeve, pa u marrë pëlqimi nga porositësi.

Kërkesa se për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontraten e bashkimit të operatorëve ekonomikë si dhe preventivin e ndarjes së punimeve të marra përsipër nga secili operator ekonomik të deklaruar në fazën e tenderimit, ka për qëllim të beje një vlerësim korrekt të kriterit për paraqitjen e kontratave të ngjashme. Kjo kërkesë bazohet edhe në parashikimet e nenit 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për paraqitjen dhe përmbushjen e kërkesave për kualifikim, e konkretisht:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

2.3.2 Liçensa profesionale e shoqërise për realizimin e punimeve, objekt i kontratës:

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI:

- **N.P - 1 A** Punime gërmimi në tokë
- **N.P - 3 C** Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
- **N.P - 7 A** Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.P –10 A** Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
- **N.P –11 A** Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- **N.P – 12 A** Punime të inxhinierise te mjedisit

PUNIME SPECIALE NDËRTIMI:

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve
- **N.S- 2 A** Impiante hidrosanitare kuzhina, lavanteri dhe mirembajtja e tyre
- **N.S - 4 B** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtues
- **N.S - 12 B** Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit

- N.S - 14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV.
- N.S - 18 A Punime topogjeodezike

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit perkates , ne plotesimin te licensave profesionale te kerkuara per ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, si dhe ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar, ku janë te percaktuar kategorite perkatese dhe niveli i klasifikimit per licensat e subjekteve qe ushtrojn veprimtari ne fushen e ndertimit.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Ne nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.*

Ne nenin 8 te ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, percaktohet:

- 1. Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendës apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse për zbatim punimesh ndërtimore.*

Ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar, parashikohet:

Licencimi, sipas kësaj rregulloreje, është i detyrueshëm për çdo subjekt juridik ose fizik vendas ose të huaj, që ushtron veprimtari ndërtimore zbatuese në Republikën e Shqipërisë pavarësisht formës së organizimit të tij.

Subjekte private a publike që kryejnë investime në ndërtime me fonde private ose prokurojnë me fonde publike kanë detyrimin për kontraktim vetëm me subjekte të licencuar, sipas kësaj rregulloreje.

2. Përkufizime:

Në kuptim të kësaj rregulloreje termat kanë këto kuptime:

"Licencë profesionale" është leja për ushtrimin e aktivitetit në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim me të cilin ka detyrimin të pajiset çdo subjekt juridik, privat ose publik, që dëshiron të ushtrojë veprimtari në fushën e zbatimit të punimeve në ndërtim dhe plotëson kushtet për t'u pajisur me një të tillë.

"Kategori" - puna në zbatim sipas llojit dhe nënlojit të objekteve, që ndërtohen ose që i shërbejnë objektit të ndërtuar.

"Klasifikim" klasifikimi i subjekteve juridikë në nivele për çdo kategori punimesh.

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

II. Klasifikimit të kategorive të përfituara duke u mbështetur në 3 elemente:

- Vlerën e punëve të ngjashme të kryera 5 vitet e fundit si shoqëri;

- Përvojën në punë të individit/ëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë;

- Kapacitetet financiare.

Kategoritë e licensave janë percaktuar në bazë të zerave të pershkruara në preventivin e projektit.

Niveli i Shoqërisë sipas vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi.

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP-1	Punime gjurmimi në tokë.	Punime gjurmimi dheu sipas preventivit: Gjurmimi dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , në kanale gjeresi > 2 m, tokezak, kategoria III, me shk në tokë >	A	0-20 milion

NP-3	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	Punime rikonstruksioni te objektit sipas preventivit: Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama; Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B; Veshje fasade me polisterol t=5cm+rrjete+suva;Veshje fasade me alukobonde; Perforcim trau me FRP me detajet e para pregatitjes dhe kapjes se FRP, perfshireu niformizimin e siperfaqes me llac special; Pregatitje e kolonave qe do te kmishohen me strukture celiku, bikomponent, skele, llac strukturor, material ngjites etj	C	51-100 milion
NP-7	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje	Punimet per ujesjelles e kanalizim te jashtem sipas preventivit:Puseteshkarkimi 80 x 80, h = 100 cm; Ndertim drenazhi mr gjrotekstil 50x120cm; F.V. Tub drenazhi Ø 150 mm; Ndertim puseta betoni H=2.5-3m, D=1m + kapak gize	A	0-20 milion
NP-10	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike	F.V. Sistem Panelesh Foto voltaik (Panele, Inverter, Kabllimet AC-DC, Panel me Automat)	A	0-20 milion
NP-11	Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	Punimet per ndricimin e jashtem sipas preventivit: F.V. Shtylle Ndricimi (7.8ml, Ndricues Led 100W, Krah 0.5x0.5, bazament, pusete 30x30, elektrode tokezimi, tel fi 10mm ² 1m); F.V. Ndricues Lulishteje Led, dekorativ (2.5m, ndricuesi Konik per shperndarjen e drites)	A	0-20 milion
NP-12	Punime të inxhnierise te mjedisit	Punimet sipas preventivit: Mbjellje bari ne skarpat	A	0-20 milion
NS-1	Punime per prishjen e ndertimeve	Punimet e prishjes sipas preventivit: Prishje kollona, trare b/a ; Prishje soleta b/a; Prishje shtresa betoni ;	A	0-20 milion

		<i>Prishje mur tulle pa pastrim etj</i>		
NS-2	<i>Impiante hidro-sanitare dhe mirembajtja e tyre</i>	<i>Punime per instalimet Hidro-Sanitare sipas preventivit: F.V. Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=90mm, Pn 16; F.V. Saracineska bronzi Ø 2 1/2" = 70 mm; F.V. Lavaman porcelani; F.V. WC allafrenga; F.V. Pilete dysHEMEJE Ø 50; F.V. Tub te zeze dhe rakorderi etj</i>	A	0-20 milion
NS-4	<i>Punime rifiniture te muratures dhe te lidhura me to, rifinitura material druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture te natyres teknike ndertuese</i>	<i>Suvatime, lyerje, punime grafiato, dyer dritare etj sipas preventivit: F.V. Dritare d/alumini plastike me dopio xham >; F.V. Dyer te brendeshme tamburate te rimesuara >; Dyer d/alumini me mbushje element d/a.; Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah; Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25; Shtrese parketi laminat; Boje hidroplastike; Veshje tavani me kartonxhes etj</i>	B	21-50 milion
NS-12	<i>Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.</i>	<i>Punimet per sistemin e ngrohje-ftohhejs sipas preventivit: Set komplet per montimin e Fan Coilit (sarcineska me hollandez DN20, bryla bronxi M/F, rakorde etj.); "Pajisje trajtimi ajri Fan Coil nedysHEME: Ft mes: 1.49 kW; Ng mes:2.09 kW ngrohje; Ajer mes: 350 m3/h, valvolen 3-vie on/off."; "Pajisje trajtimi ajri Fan Coil ne dysHEME: Ft mes: 2.32 kW ; Ng mes: 3.19 kW ngrohje ; Ajer mes: 460 m3/h, valvolen 3-vie on/off."; "Pajisje trajtimi ajri Fan Coil ne dysHEME: Ft mes: 3.6 kW; Ng mes: 4.36 kW ngrohje ; Ajer mes: 706 m3/h, valvolen 3-vie on/off." etj</i>	B	21-50 milion
NS-14	<i>Impiante te brendshme elektrike telefoni radiotelefoni TV</i>	<i>Rrjeti i brendshem elektrik sipas preventivit: F.V. Tub plastmasi Ø 14-17mm; F.V.</i>	A	0-20 milion

		<p>Çeles 1 polar 220V 10A; F.V. Priza shuko universal; F.V. Percjelles Tokezimi, Cu, S=50mm² i zhveshur; F.V. Percjelles shirit Zn 30x3mm; Automat magneto-termik MCB, tipC40N, In=20A/1P+N, kl. C Icc=10 KA; F.V. Kuti shperndarese j/m. me kapak PT-2-5 dim. 150*100*100 mm; F.V. Ndriçuesha Plafon me Led 26W, IP 65, 220V etj</p>		
NS-18	Punime topogjeodezike	Punimet topogjeodezike sipas projektit	A	0-20 milion

2.3.3 Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën dhe listpagesat e shoqërisë, dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt dhe për të cilin duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) Kontratë pune
- b) Diplomë

(Ne rastin e Bashkimit të Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçensën e shoqërisë dhe të deklarojë se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt në varesi të vlerës së preventivit të punimeve që ka marrë persiper sipas përqindjes së bashkepunimit.)

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues për drejtuesin teknik, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 448, datë 31.07.2005 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës.

Ne nenin 77 të LPP nder të tjera parashikohet: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

Ne nenin 39, pika 6/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

- c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës;

Ne nenin 3 “Perkufizime”, pika 12 te ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, përcaktohet: “Drejtnes teknik” është personi fizik, i përcaktuar në licencën e shoqërisë, i cili është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specififikimet teknike, standardet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Në VKM nr. 448 , datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TË NDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT”, neni 8, pika 2, përcaktohet se: Drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejt nga drejtuesi teknik i zbatuesit ose përgjegjësi teknik i kantierit. Për vepra me vlerë të plotë, të preventivuar mbi 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë, përgjegjësi teknik i kantierit është rezident, me kohë pune të plotë në objekt dhe i diplomuar në inxhinieri ndërtimi.

2.3.4 Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik (drejtnesit teknike) për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të cilët duhet të figurojnë në licencën si dhe listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit, si mëposhtë:

- Inxhinier Ndërtimi, Profili strukturist 1 (një)
- Arkitekt 1 (nje)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Mjedisi 1 (nje)
- Inxhinier Gjeodet/Totograf 1 (një)

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës noteriale e vlefshme dhe diploma.

Drejtnesit teknik duhet të jenë të punësuar sipas kriterëve të VKM nr. 42 date 16.01.2008, i ndryshuar, sa i takon ndalimeve të dypunësimit. **Per kete arsye te paraqitet deklarate perkatese nga Administratori i shoqerise.**

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipër do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në të nenin të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar, ligjin nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, si dhe në VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Numri i stafit kryesor teknik si numri i inxhinierëve është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

Ne nenin 3 “Perkufizime”, pika 12 te ligjit nr. 8402, date 10.09.1998 “PËR KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TË NDËRTIMIT”, i ndryshuar, percaktohet: “Drejtues teknik” është personi fizik, i përcaktuar në licencën e shoqërisë, i cili është përgjegjës për organizimin dhe drejtimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me projektin, preventivin, specifikimet teknike, standartet dhe grafikun e miratuar, deri në kolaudimin e objektit.

Ne nenin 8 të VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT” percaktohet: 1. Detyra e drejtuesit teknik të zbatuesit të punimeve është e papajtueshme me çdo punëmarrje tjetër, publike a private, jashtë subjektit sipërmarrës.

Ne Vendimin e Keshillit të Ministrave nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar, parashikohet:

KREU III

KATEGORIZIMI DHE KLASIFIKIMI I LICENCËS, ELEMENTET E SAJ, KUSHTET, KRITERET DHE KUFIZIMET

1. Kategorizimi dhe klasifikimi i licencës, garanci

a) Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas:

I. Kategorive të punimeve të zbatimit duke u mbështetur në:

- profilin e diplomës universitare të individëve që punësohen në rolin e drejtuesit teknik të shoqërisë.

Punimet apo veprimtaritë konkrete, te cilat lidhen edhe me kategorite e licenses, për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale:

<i>Inxhinier Ndërtimi, profili strukturist</i>	<i>Inxhinieri Strukturist eshte pergjegjes per sigurimin e zbatimit e te gjitha aspekteve te projektit per objektin qe do te ndertohet. Projekti, objekt i kësaj kontrate parashikon një tipologji të punimeve të përgjithshme ndërtimore, të tilla si punimet e prishjes, punimet e gërmimit, punimet e konstruksionit te celikut, punimet e shtresave, etj. si edhe punimet perforcuese ne trare apo kolona. Zbatimi i punimeve të përgjithshme ndërtimore dhe zbatimi i punimeve strukturore duhet të realizohet me materialet dhe teknologjitë e parashikuara në projektin e zbatimit, metodologjia e ndjekur e zbatimit të këtyre punimeve duhet të përputhet me specifikimet teknike dhe standartet dhe kriteret e zbatimit nga ekspert inxhinier ndërtimi, i profilit strukturist. (Punime Rikonstruksioni, Germimi, Prishje, Rifiniture), te cilave i konrrespondjne kategorite NP-1, NP-3, NS-1, NS-4.</i>
<i>Inxhinier Hidroteknik</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve Hidrosanitare, Kanalizime, te cilave i konrrespondon kategoria NP-7, NS-2.</i>
<i>Inxhinier Elektrik</i>	<i>Eshte pergjegjes per punimet e rrjetit te brendshem elektrik dhe telefonise, punimet elektrike ne ambjentet e jashtme, punimet per</i>

	<i>sistemin fotovoltaik, te cilave i konrrespondojne kategorie NP-10, NP-11, NS-14.</i>
<i>Inxhinier Mekanik</i>	<i>Eshtë pergjegjes për ndjekjen e realizimit të punimeve të preventivit per instalimin e sistemit ngrohje-ftohje, punimet per f.v. konstruksione metalike, punime qe perfshihen ne kategorie NS-12</i>
<i>Arkitekt</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve sipas parashikimeve në projektin arkitektonik dhe zgjidhjet arkitektonike. Monitoron ndërtimin ose restaurimin në përputhje me specifikimet dhe standardet e cilësisë. (Fasada, materialet qe do te perdoren, aspektet funksionale dhe estetike etj)</i>
<i>Inxhinier mjedisi</i>	<i>Eshte i nevojshem qe te jete prezent ne proceset e punes se krijimit te hapësirave te gjelberta, te cilat do te jene krejtesisht te reja, te parashikuara ne projekt preventiv: Mbjellje bari ne skarpat. Kerkesa eshte ne proporcion me natyren e punimeve dhe volumin e tyre.</i>
<i>Inxhinier Gjeodet</i>	<i>Eshtë përgjegjës për zbatimin e punimeve topogjeodezike, punime qe perfshihen ne kategorie NS-18</i>

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik, punonjës të kualifikuar dhe te thjeshte, si mëposhtë:

- 1 (nje) Inxhinier Elektronik/Telekomunikacioni
- 1 (nje) punonjës teknik ndërtimi
- 1 (një) punonjës teknik topograf
- 1 (një) teknik mekanik
- 4 (kater) elektrikiste
- 4 (kater) hidraulike
- 4 (kater) karpentiere
- 3 (tre) hidroizolues
- 3 (tre) hekurkthyes
- 2 (dy) betonues
- 4 (tre) suvatues
- 3 (tre) bojaxhinj
- 2 (dy) punonjes per montim-çmontim skeleri
- 2 (dy) specialiste per punime me gips
- 4 (kater) muratore
- 3 (tre) pllaka shtrues
- 1 (nje) specialist duro alumin
- 2 (dy) saldatore
- 1 (nje) mekanik
- 2 (dy) specialiste instalues të sistemeve ngrohje-ftohje
- 1 (një) specialist i çertifikuar për sistemet CCTV
- 3 (tre) shofere
- 2 (dy) manovratore eskavatoriste
- 1 (nje) manovrator buldozerist

- 3 (tre) manovratore automakiniste
 - 15 (njetzet e pesembedhjete) punonjës të thjeshtë/ndihmes
 - Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.
- Per inxhinierin te paraqitet diploma perkatese e leshuar nga Institucione Arsimore te Arsimit te Larte te akredituara.
 - Për teknikun e ndërtimit, teknikun topograf dhe teknikun mekanik do të pranohet vetem diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.
 - Per punonjesit e kualifikuar te ndertimit te paraqitet Çertifikatat/diplomat/deshmia te leshuara nga institucione publike/private te licencuara sipas ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, i ndryshuar.
 - *Nuk do të njihen si dëshmi profesionale kurset e trajnimit të lëshuara nga subjektet të cilat nuk janë të licensuara/akredituara nga institucionet përkatëse për licensimin/akreditimin e tyre.*
 - Ndersa per punonjesit shofere dhe manovratorë të mjeteve të rënda duhet të paraqiten deshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore.
 - Në rast se operatori ekonomik, i disponon mjetet në pronësi, duhet ti ketë drejtuesit e mjeteve (shoferet dhe manovratorët) në listëpagesë për tre muajt e fundit.
 - **Për mjetet, të cilat janë të marra me qira, OE duhet të paraqesë për shoferet dhe manovratorët, kontratën e punës së vlefshme, deshmi te aftesise profesionale / leje drejtimi dhe certifikate e aftesimit profesional sipas rastit, të lëshuara nga D.P.SH.T Rrugore, por pa qenë e nevojshme që këta të figurojnë në listëpagesën e OE.**

Per profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotesoje tabelën si me poshtë:

Nr.	Emer Mbiemer i punonjesit	Profesioni i punonjesit ne certifikate/diplome	Emri i Institucioni publik/privat leshues i certifikates/diplomes	Numri indetifikues i certifikates/diplomes	Nr NIPT - (Ne rast se leshuesi eshte institucion privat)
1					
2					
.....					

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mësipërm do të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit.**

Argumentimi: Vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i dryshuar, ligjin nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“, i ndryshuar; ligjin 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË

SHQIPËRISË”, i ndryshuar; VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjësit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projekt zbatimin dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kanë përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 39, pika 6/c)/ç, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës.

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne neni 4 “Perkufizime”, te ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet :

“Kualifikimi profesional” është një sistem njohurish, aftësish, qëndrimesh dhe vlerash, të cilat mundësojnë ushtrimin me sukses të një aktiviteti të caktuar profesional, i cili mund të përftohet nëpërmjet mësimnxënies te një ofrues i AFP-së, i përmbyllur me provime dhe i certifikuar nëpërmjet një dokumenti përkatës (certifikatë).

“Certifikatat/dëshmitë/diplomat” janë dokumente zyrtare të llojeve të ndryshme, të lëshuara nga një organ certifikues, të cilat regjistrojnë arritjet e një individi pas vlerësimit, sipas një procedure e standardi të paracaktuar.

“Akreditimi” është njohja formale që një institucion mund të kryejë detyrat për të cilat është licencuar. Akreditimi i një ofruesi të AFP-së është procesi i sigurimit të cilësisë së ofruesit që tregon se institucioni është i miratuar nga autoritetet përkatëse dhe që ka përmbushur standarde të paracaktuara. “Lista Kombëtare e Profesioneve” klasifikon profesionet, bazuar në llojin e punës e në kompetencat e nevojshme dhe përbëhet nga emërtimet përkatëse të profesioneve/punëve e nga përshkrimet e profesioneve.

Ne nenin 12 te ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet:

1. AFP-ja ofrohet nga institucionet publike dhe private.
2. Institucionet ofruese të AFP-së janë:
 - a) shkollat e mesme profesionale;

- b) qendrat shumëfunktionale të AFP-së;
- c) qendrat e formimit profesional;
- ç) institucionet e specializuara të AFP-së për grupet e veçanta;
- d) shoqëritë tregtare;
- dh) institucionet e tjera të licencuara dhe/ose të akredituara ose individët

Ne nenin 29 të ligjit nr.15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional ne R.SH“ i ndryshuar, nder te tjera, percaktohet:

1. Certifikata e kualifikimit profesional i lëshohet një individ, i cili i ka përmbushur standardet përkatëse të kualifikimit, pas një procesi vlerësimi formal.
2. Dokumentet e certifikimit lëshohen nga ofruesi i AFP-së.

Ne nenin 7, pika 12 të VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT nder te tjera, percaktohet:

12. Zbatuesi i punimeve detyrohet të sigurojë në kantier:
 - a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesioneve të veçanta (dëshmi, leje, autorizime) nga organet e autorizuar me ligj;
 - d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë.

Ne nenin 115, pika 1 të ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

1. Ndalohet drejtimi i automjeteve dhe motomjeteve pa marrë lejedrejtimi, të parashikuar nga ky Kod.
- Ne nenin 178, pika 5 të ligjit 8378 date 22.07.1998 “KODI RRUGOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, i ndryshuar, percaktohet se:

5. Drejtuesi i mjetit duhet të ketë me vete certifikatën e aftësisë profesionale, kur ajo kërkohet.

Në përcaktimin e profileve konkrete të stafit teknik punonjësve të kualifikuar, si dhe numrit të tyre, AK është bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”; VKM nr. 514, date 20.09.2017 “Per miratimin e listes kombetare të profesioneve (LKP), të rishikuar; Urdherin nr.200, date 16.05.2019 të Ministrit të Infrastruktura dhe Energjitikes “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit“, Ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zëra dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinier Elektronik/Telekomunikacion** është i nevojshëm për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet për secilin nga zërat e punimeve për instalimin e sistemit të fonise dhe kamerave. Kërkesa është në proporcion me natyrën e punimeve dhe volumin e tyre.
- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve, sic janë germimet, punimet e shtresave, punimet e betonit, punimet e muratures etj, lexon dhe kontrollon zbatimin e projektit në përputhje me kushtet teknike të zbatimit (KTZ), implementon kërkesat dhe direktivat e inxhinierit dhe ndan detyrat për punetoret dhe ndjek ecurinë e tyre gjatë kohës së punës.
- **Tekniku topograf** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, për zbatimin e saktë të kuotave të projektit duke asistuar drejtuesin teknik.

- **Tekniku Mekanik** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve mekanike për instalimin e sistemit ngrohje ftohje, paneleve fotovoltaike, sipas zërave të preventivit duke asistuar drejtuesin teknik.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për punimet beton arme, punime themeli, kollona e soleta sipas zërave të preventivit. Bejne piketimin dhe armaturen anesore të themelit, bejne vendosjen e modinave për kolonat dhe muret e betonit, ndertojne armaturen, kallepet e kolonave, mureve, montojne skelerine perforcuese për fazen e betonimit të mureve dhe kolonave, prerjen dhe montimin e strukturave prej druri e metali si dhe ndërtimin e kornizave dhe strukturave të tjera perforcuese prej druri, bashkimin dhe montimin e elementëve metalik apo materiale të tjera, të nevojshme për realizimin e objektit që do të ndërtohet. Numri i kerkuar është bazuar të grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve karpentiere (punimet e betonit dhe b/a) është parashikuar të realizohet në muajin e dytë, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo ze të punimeve të parashikuara në preventiv. Duke pasur parasysh volumin e konsiderueshëm dhe grafikun duhen min 4 punonjes të kualifikuar.
- **Hekurkthyesi** është i nevojshëm për përzgjedhjen, prerjen, kthimin dhe vendosjen e hekurit, për realizimin zërave të punimeve të hekur betonit sipas preventivit. Numri i kerkuar është bazuar të grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve hekurkthyes është parashikuar të realizohet në muajin e dytë, trete dhe të dhjetë, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo ze të punimeve të parashikuara në preventiv. Kështu sipas manualit orët e punës për të perfunduar punimet e hekurit janë 2736 ore, që të kthyer në ditë janë 342 ditë pune ($2736/8=342$). Duke llogaritur që sipas grafikut janë parashikuar të perfundojnë në 22 ditë del që nr. i punonjesve duhet të jete rreth 16 persona. ($342/22=15.5$). Janë llogaritur minimumi 3 punonjes të kualifikuar. Llogaritja e kohës ditore dhe javore të punës janë bera bazuar në percaktimet e kodit të punës. (koha ditore e punës 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 ditë pune në muaj).
- **Hidroizoluesit** janë të nevojshëm për punimet e izolimit sipas zërave të preventivit. Studiojnë projektin përkatës për të përcaktuar llojin, cilësinë dhe sasinë e materialeve të nevojshme për izolim. Bëjnë lyerjen e sipërfaqes me praimer (zift i shkrirë) për hidroizolim; Përgatitin pajisjet dhe materialet e duhura për ngjitjen e letrës; Shtrojnë letrën katrama (deri në tre shtresa), por në drejtime të ndryshme; Bëjnë termo-izolimin me materialin e duhur (polisterol, lesh xhami etj.) Numri i kerkuar është bazuar të grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve izolues është parashikuar të realizohet në muajin e trete dhe të tetë, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar në manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” për kohën e punës që duhet për të realizuar çdo ze të punimeve të parashikuara në preventiv. Kështu sipas manualit orët e punës për të perfunduar punimet e termoizolimit janë rreth 5632 ore, që të kthyer në ditë janë 704 ditë pune ($5632/8=704$). Duke llogaritur që sipas grafikut janë parashikuar të perfundojnë në 22 ditë del që nr. i punonjesve duhet të jete 32 persona. ($704/22=32$). Janë llogaritur minimumi 3 punonjes të kualifikuar. Llogaritja e

kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Betonuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit sipas zerave të preventivit. Ndhmon në ndërtimin e armaturës brenda së cilës do derdhet betoni, vendosin shtyllat mbajtëse të peshës, morsetat dhe mjetet e tjera që sigurojnë qëndrueshmërinë e armaturës ndaj peshës dhe presionit të ngarkesës beton, Shpërndajnë betonin dhe e shtrojnë atë në soleta, kolona, shkallë, mure, ballkone, ura, apo strukturave të tjera në kohën e duhur, sipas radhës së përcaktuar nga projekti dhe drejtuesi teknik i objektit, bëjnë vibrimin e betonit gjatë çdo betonimi, kryejnë nivelimin e betonit, kryejnë lustrimin e betonit apo çimentos. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve betonues është parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, te peste dhe te shtate, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Duke qene se prezenca me e madhe kerkohet ne muajin e dyte, atehere, duke ju referuar grafikut dhe sasise se betonit qe do te hdhet duhen min 2 punonjes te kualifikuar betonues.
- **Specialist gipsi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të tavaneve me gips sipas zerave të preventivit. Përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips duke bërë matjet dhe prerjet e duhura. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve suvatues është parashikuar te realizohet ne te tre muajt, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv.
- **Pllaka shtruesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të shtrimit të pllakave sipas zerave të preventivit të punimeve. Shtruesi i pllakave (pllaka shtruesi) dhe të tjerë që lidhen me to instalon, mirëmban dhe riparon parkete dhe lloje të tjera të dyshemeve ose mbulojnë dyshemetë, muret ose sipërfaqet e tjera me pllaka ose panele mozaikësh për qëllime dekorimi ose të tjera. Studiojnë projektin përkatës për sipërfaqet që do të shtrojnë; Përgatitin sipërfaqen e dyshemesë për t’u mbuluar me parket, pllaka ose materiale të tjera; Bëjnë nivelimin e sipërfaqes me material mbushës (rërë e çimento apo material i gatshëm mbushës prodhuar apopersonelat për këtë funksion); Bëjnë matjen dhe prerjen e pllakave sipas projektit; Vendosin pllakat apo materialet e tjera në dysheme sipas skicës dhe përshkrimeve të tjera, duke respektuar afatet e mpiksjes së materialeve; Montojnë pjesët e parketit etj. Numri i kerkuar është bazuar te grafiku i punimeve, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e shtrimit te pllakave ne muajin e peste jane 1914 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 239 dite pune ($1914/8=239.2$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 16 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 15 persona. ($239/16=14.9$). Jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne

percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Suvatuesi** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te suvatimit sipas zërave të preventivit. Kryejen vendosjen e një ose më shumë shtresave të suvasë në muret e brendshme dhe në tavanet e godinave duke realizuar një sipërfaqe të lëmuar. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve suvatues eshte parashikuar te realizohet e shtrire ne 4 muaj, nga muaji e peste deri ne muaji e tete, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e suvatimit te parashikuara per tu realizuar nga muaji i peste deri ne muaji e tete jane rreth 5117 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 640 dite pune ($5117/8=639.6$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 44 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 15 persona. ($640/44=14.5$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Muratori** është i nevojshëm për realizimin e punimeve te muraturës, soletave etj. sipas zërave të preventivit. Bëjnë piktimin e mureve të objektit, bëjnë përgatitjen e sasisë së nevojshme të llacit për procesin ditor të punës, bëjnë breza përforcues betoni në gjysmën e lartësisë së murit ose sipas specifikimit në projekt; kontrollojnë nëse muret janë të lidhur midis tyre horizontalisht dhe vertikalisht duke garantuar kështu qëndrueshmërinë e tyre, ndërtojnë soletat, vendosin arkitrarët e dyerve dhe dritareve, bëjnë mbushjen me llac të mureve në nivelin e fashove me dorë ose me pompë në varësi të materialit të përcaktuar nga drejtuesi teknik në objekt, përgatitin materialin e nevojshëm për tavane me gips apo për tavane të varura zbukurues duke bërë matjet dhe prerjet e duhura. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve muratore eshte parashikuar te realizohet ne muajin e katert, si dhe tek perllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet murature tulle jane rreth 2770 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 346 dite pune ($2770/8=346.25$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 16 persona. ($346/22=15.7$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Bojaxhiu** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të lyerjes me boje sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryen përgatitjen e sipërfaqeve të ndërtesave dhe strukturave të tjera për lyerje, kryen përgatitjen e materialeve që do të përdoren për lyerje, bejne stukime, zmerilime, pastrime, kryejnë lyerjen me astar të sipërfaqes për lidhjen e saj me bojën, kryejnë lyerjen përfundimtare të sipërfaqeve me ngjyrat e përgatitura, bëjnë lyerjen me materiale përkatëse dhe bojëra mbrojtëse të sipërfaqeve të drunjtja, të strukturave metalike, kornizave të hekurta të ndërtesave. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku te gjitha punimet ku kerkohet

prezenca e punonjesve bojaxhinj eshte parashikuar te realizohet ne muajin e njembedhjete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet e lyerjes me boje ne muajin e njembedhjete jane rreth 1355 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 169 dite pune ($1355/8=169.37$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 14 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 12 persona. ($169/14=12.07$). Jane llogaritur minimumi 3 punonjes te kualifikuar bojaxhinj. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Elektricitisti** është i nevojshem për realizimin e punimeve elektrike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Shqyrtojnë projektet, skicat e instalimeve elektrike dhe specifikimet përkatëse; Përcaktojnë hyrjen kryesore të rrjetit elektrik në objekt; Kryejnë shtrimin e kolonës kryesore të energjisë elektrike; Bëjnë shtrimin e tubave dhe fiksimin e tyre; Kryejnë shtrirjen e përcjellësve në tuba; Bëjnë lidhjen e telave në kutitë shpërndarëse; Kryejnë montimin e çelësave, prizave dhe të automateve etj. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet elektrike jane parashikuar te realizohen ne muajin e gjashte shtate dhe te tete, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet elektrike ne muajin e gjashte jane rreth 1678 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 210 dite pune ($1678/8=209.75$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 14 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete 15 persona. ($210/14=15$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar elektriciste. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Hidrauliku** është i nevojshem për realizimin e punimeve hidraulike, sipas zërave të preventivit të punimeve. Numri i kerkuar eshte bazuar te grafiku i punimeve, ku punimet hidraulike jane parashikuar te realizohen ne muajin e gjashte dhe te shtate, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Keshtu sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet ku perfshihen edhe ato hidraulike ne muajin e gjashte dhe te shtate jane rreth 2400 ore, qe te kthyer ne dite jane 300 dite pune ($2400/8=300$). Duke llogaritur qe sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 14 persona. ($300/22=13.6$). Jane llogaritur minimumi 4 punonjes te kualifikuar hidraulike. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).
- **Saldatori** është i nevojshem për realizimin e punimeve sipas zërave të preventivit: F.v konstruksione metalike te perbera; F.v konstruksione metalike. Numri i kerkuar eshte bazuar te

grafiku i punimeve, ku punimet ku kerkohet prezenca e punonjesve saldatore eshte parashikuar te realizohet ne muajin e dyte, te trete dhe te gjashte, si dhe tek perlllogaritjet e bera bazuar ne manualin e çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, date 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar per informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” per kohen e punes qe duhet per te realizuar cdo ze te punimeve te parashikuara ne preventiv. Sipas manualit oret e punes per te perfunduar punimet per konstruksione metalike te perbera te parashikuara per tu realizuar ne muajt e trete jane 4050 ore, qe te kthyer ne dite jane rreth 506 dite pune ($4050/8=506.25$). Duke llogaritur qe keto punime sipas grafikut jane parashikuar te perfundojne ne 22 dite del qe nr. i punonjesve duhet te jete rreth 23 persona. ($506/22=23$). Jane llogaritur minimumi 2 punonjes te kualifikuar saldatore. Llogaritja e kohes ditore dhe javore te punes jane bere bazuar ne percaktimet e kodit te punes. (koha ditore e punes 8 ore dhe ajo javore 40 ore, gjithsej 22 dite pune ne muaj).

- **Mekaniku** është i nevojshem për realizimin e punimeve mekanike, sipas zërave të preventivit të punimeve : F.V Konstruksione metalike te perbera; F.V. Sistem Panelesh Fotovoltaik (Panele, Inverter, Kabllimet AC-DC, Panel me Automat); Punimet per instalimin e sistemit te ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit (Fan-Coil). Ben **prerjen dhe kalibrimin** e profileve metalike sipas përmasave të projektit, fiksimin mekanik gjatë montimit. Ai siguron që struktura mbajtëse (nga alumini ose çeliku i galvanizuar) të jetë e ankoruar siç duhet pa dëmtuar stabilitetin e ndërtesës. Instalojnë dhe kalibrojnë valvulat që mbrojnë pompën kryesore të sistemit (Kaldajës ose Pompës së nxehtësisë).
- **Specialsti per montim-çmontim skeleri** eshte i nevojshem per punimet sipas preventivit ku kerkohet vendosja e skelerise, si: Veshje fasade me polisterol $t=5\text{cm}$ + rrjete + suva; Veshje fasade me alukobonde; Boje hidroplastike cilesi e larte. Montojnë apo çmontojnë skela të përkohshme prej metali ose druri në vend-punime të ndryshme; rrethojnë vendin, ku do të punohet, me skela e rrjeta mbrojtëse dhe tabela lajmëruese; ngrene shtyllat, traversat, bejne lidhjet diagonale dhe platformave; shkeputin ne menyre te kontrolluar strukturën pas përfundimit të punimeve.
- **Specialist duro alumini** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të vendosjes se dyerve dhe dritareve d/alumini sipas zërave të preventivit të punimeve. Kryejnë matje në objektin ku do të bëjnë punime duro-alumini; Presin dhe përgatitin objekte (dyer, dritare etj.) për porosinë e marrë duke u mbështetur në përmasat e kasë; Presin dhe vendosin xhama në dritaret e gominave; Kryejnë punime të ndryshme të duro-aluminit në ndërtesa.
- **Specialist i çertifikuar për sistemet CCTV** lidhet drejtpërdrejte me zerat e preventivit si: F.V. NVR, 32 Porta; F.V. Kamera per ambient te Jashtem, 4 M-pixel; F.V. Kamera te brendshme, 5 M-pixel etj, instalimi dhe konfigurimi i te cilave kerkon specialist te certifikuar per kete qellim.
- **Specialist instalues të sistemeve ngrohje-ftohje** për realizimin e punimeve per instalimin e sistemit ngrohje-ftohje (çillërave) dhe paneleve diellore sipas zërave të preventivit. Instaluesi dhe riparuesi i kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse merret me parapërgatitjen, montimin dhe instalimin e kondicionerëve, kaldajave, paneleve diellore, çillërave (sistemeve ngrohëse-ftohëse), si dhe kryen riparime apo punime mirëmbajtjeje në sistemet e ngrohje-ftohjes. Ai mund të punësohet në kompani të shërbimeve të ndërtimit apo të vetëpunësohet. Kontrollon vendin ku do të kryejnë montimin e pajisjet ftohëse-ngrohëse për të kryer modifikimet e duhura; Bëjnë shtrirjen e tubave të bakrit në dysheme dhe mure (në rastin e kaldajës, çillerit, apo paneleve diellore) sipas projektiveve përkatëse; Montojnë tubat e bakrit në pajisjen e brendshme

(kondicionerit, kaldajës, çillerit); Montojnë motorin e kondicionerit, kaldajën apo panelin diellor etj.

- **Shoferi** është i nevojshëm për drejtimin e mjeteve si kamione, kamionçina. Numri i kërkuar është bazuar në grafikun dhe numrin e mjeteve që duhen për transportin e materialeve të ndërtimit të dalë nga prishja, si dhe transportin e materialeve që do të përdoren për realizimin e objektit.
- **Manovratori eskavatorist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **eskavator germimi dhe fadroma të të gjitha llojeve**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa a, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

a)-eskavator germimi e ngarkimi dherash të të gjitha llojeve si dhe fadromat e të gjitha llojeve (me goma dhe me zinxhirë), manovratorëve u jepet dëshmi për **ESKAVATORIST**.

- **Manovratori buldozerist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **rrul vibrues**, i cili është kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e kësaj makinerie. Në nenin 8, germa b, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

b)- buldozer germimi, shtyrje, nivelimi e ngjeshje dherash apo shpim toke: të gjithë llojet e traktorëve me thikë (ruspë), ose që tërheqin skreper, grejder apo nivelues, rul vibrues, shtruese asfalto-betoni, skreperët, grejderët dhe niveluesit kur janë vetëlëvizës, të gjithë llojet e traktorëve, me pajisje shtesë për ngritjen e peshave, shpimin e puseve etj. **manovratorëve u jepet dëshmi për BULDOZERIST**.

- **Manovratori automakinist** është i nevojshëm për përdorimin e makinerive të rënda të ndërtimit si **autobetoniere, autovinca, autopompe betoni**, të cilat janë kërkuar pasi në preventiv janë parashikuar punime që kërkojnë përdorimin e këtyre makinerive. Në nenin 8, germa c, të rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës përcaktohet: Makineritë e rënda të ndërtimit dhe emërtimet bëhen sipas Dëshmive të Aftësive Profesionale (DAP), të cilat ndahen si më poshtë:

c)-Automjete për përdorim të veçantë (APV) sipas pikës “g”, të nenit 54, të Kodit Rrugor, makineri ndërtimi mbi bazë automjeti:-**autovinça, autobetonierë, autopompa betoni**, autobitumatriçe, autosonda, autotokmak, manovratorëve u jepet dëshmi për **AUTOMAKINIST**.

2.3.6 Nje punësim mesatar per tre muajt e fundit, i të paktën **80** (tetedhete) personave të vërtetuar me:

- a) Vërtetim të lëshuar nga autoritetet përkatëse, në mënyrë elektronike, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj;
- b) Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhen e kërkuar.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues që OE i disponon punonjesit e mesipërdo të dorëzohet nga **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne nenin 77 të LPP ndër të tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Autoriteti kontraktor në përcaktimin fuqisë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës është bazuar në llogaritjen e orëve të punës sipas manualit të çmimeve të ndërtimit miratuar me VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”; VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT; VKM nr. 514, datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP), të rishikuar; Urdherin nr.200, datë 16.05.2019 të Ministrisë të Infrastruktura dhe Energjitikës “Për miratimin e rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e dëshmisë së aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtimi dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të makinerive të ndërtimit”; ligjin Nr. 7961, datë 12.7.1995 “KODI I PUNËS I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË“, i ndryshuar; grafikun e punimeve, zërat e punimeve të preventivit, volumet për keto zera. **Duke e bazuar në keto komponente AK përcaktoi stafin kryesor teknik (inxhinieret), një numer minimal punonjësish të kualifikuar për çdo lloj punimesh dhe një numer minimal punonjësish të thejshme/ndihmes. Nga ky numer rezultoi se për të perfunduar brenda afatit dhe me sukses**

zbatimin e kontrates operatoret ekonomike pjesemarres duhet te kene minimalisht nje numer prej 80 punonjesish (stafi kryesor teknik + punonjes te kualifikur + punonjes te thejshte/ndihmes).

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij punonjes te certifikuar si me poshte:

- 4 (kater) punonjës të certifikuar për “*Punime në lartësi*”, sipas VKM-së Nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, e dhënë nga një organizem i liçencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar).
- 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e pare dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, (i ndryshuar).

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit.

- 1 (nje) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert Zjarrefikes”, lëshuar nga MZSH. Disponimi i këtij punonjësi mund të sigurohet nëpërmjet kontrates se punes, e cila duhet te jete e vlefshme gjate gjithë kohezgjatjes se ekzekutimit te kontrates.
- 1 (një) Auditues energjistik i certifikuar nga Agjencia për Efiçencën e Energjisë, në ndërtesa. Disponimi i këtij punonjësi mund të sigurohet nëpërmjet kontrates se punes, e cila duhet te jete e vlefshme gjate gjithë kohes se ekzekutimit te kontrates.
- 1 (një) person, i certifikuar si Specialist Për Testimin e Performances së Produkteve te Ndërtimit. Disponimi i këtij punonjësi mund të sigurohet nëpërmjet kontrates se punes, e cila duhet te jete e vlefshme gjate gjithë kohes se ekzekutimit te kontrates.

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues qe OE i disponon punonjesit e mesipermdo të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Këto kriterë janë vendosur bazuar në nenin të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; nenin 39, pika 6/c) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Ligjin Nr.8402, date 10.9.1998 “PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT”, i ndryshuar; ligjin 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar; VKM Nr.312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar; VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT; ligjin nr.152/2015 “Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin“; Ligjin Nr. 124/2015 “Për Efiçencën e Energjisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 116/2016 “Për performancën e Energjisë së Ndërtesave”; Vendimin Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesave”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Njësia e prokurimit gjykon se në zbatim të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni sektorial në fuqi për mbarëvajtjen e punimeve, me qëllim garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident si dhe në zbatim të detyrimeve që rrjedhin për mbrojtjen nga zjarri dhe eficienten e energjise, është e nevojshme prezenca e eksperteve dhe punonjesve të certifikuar të kerkuar.

Ne nenin 77 të LPP nder të tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Ne nenin 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Ne nenin 7, pika 12 të VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT nder të tjera, përcaktohet:

12. Zbatuesi i punimeve detyrohet të sigurojë në kantier:

a) punëmarrës të aftë, të kontrolluar për shëndetin, me leje për ushtrim profesionale të veçanta (dëshmi, leje, autorizime) nga organet e autorizuar me ligj;

d) punonjës të kualifikuar dhe të autorizuar prej tij për instruktimin teknik dhe mbrojtjen në punë dhe rregullore, urdhra e udhëzime në fuqi për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë;

e) librin e instruktimit për sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë të punëmarrësve.

ë) librin për trajnimin e punonjësve për mbrojtjen nga zjarri dhe raportin e stimulimit periodik të evakuimit të punonjësve, **të nënshkruara nga një ekspert zjarrfikës**. Simulimi realizohet të paktën 1 herë në 6 muaj.

Ne nenin 3 pika 29 të ligjit nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin” parashikohet se:

29. “Ekspert zjarrfikës privat” është personi fizik dhe juridik, i certifikuar, i cili harton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryen aktin e ekspertizës për zjarrin e rënë, kryen trajnime në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas dispozitave të këtij ligji.

Eksperti zjarrfikës është i domosdoshëm të jete prezent në fazën e realizimit të projektit të zbatimit të mbrojtjes ndaj zjarrit dhe vlerësimeve perkatese të fushës.

Në nenin 6 të ligjit Nr. 10237 date 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar parashikohet:

”Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi, për sigurimin e mbrojtjes së punëmarrësve në të gjitha aspektet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë, merr masat e nevojshme nëpërmjet:

- a) parandalimit të rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;
- b) informimit dhe formimit profesional të punëmarrësve e të përfaqësuesve të tyre;
- c) organizimit të mbrojtjes kolektive dhe individuale;
- ç) sigurimit të organizimit të vendit të punës e të mjeteve të nevojshme.

2. Punëdhënësi kujdeset për përditësimin e masave të parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duke marrë parasysh ndryshimet e rrethanave, për përmirësimin e situatave ekzistuese.

Ne nenin 7 Shërbimet e mbrojtjes dhe të parandalimit, parashikohet:

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

Ne nenin 8 gërma “e” parashikohet: Punëdhënësi cakton të paktën një punëmarrës të trajnuar, i cili mund të japë ndihmën e shpejtë, të fikë zjarrin ose të kryejë veprime shpëtimi a evakuimi dhe, nëse ka më tepër se 20 persona, që punojnë në të njëjtin mjedis pune, duhet të ketë të paktën dy punëmarrës të trajnuar për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Në pikën 15 të V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet:

15.1 Përkufizime

Në aplikimin e këtyre rregullave, kërkesave, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

- a) pajisje pune është çdo makinë, aparat, instalim që përdoret në punë;
- b) përdorim i një pajisje pune: çdo operacion pune i lidhur me një pajisje pune në përdorim ose jo, transporti, riparimi, transformimi, mirëmbajtja, pastrimi, çmontimi;
- c) zonë e rrezikshme: çdo zonë brenda ose në afërsi të një pajisje pune, në të cilën prania e një punëmarrësi përbën rrezik për shëndetin ose sigurinë e tij.
- ç) **puna në lartësi: aktivitet pune e cila ekspozon punëmarrësin ndaj rrezikut të rënies nga një lartësi më e madhe se 2 metra, referuar një niveli të palëvizshëm.**

Persa i perket Audituesit Energjetik sqarojme se kriteri eshte vendosur ne perputhje me Ligjin Nr. 124/2015 “Për Eficiency e Energjisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr. 37/2025 “Për performancën Energjetike të Ndërtesave”; Vendimin Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesave”. Duhet që godina ne perfundim te pajiset me certifikaten perfundimtare te performances se energjise, per kete arsye do te duhet monitorimi hap pas hapi i te gjithe elementeve te godines dhe shtresave /mbeshtjellsave te saj, ne menyre qe te permbushe qellimin dhe godina te plotesoje klasifikimin minimal energjetik.

Ne nenin 16, pika 5/b te Ligjit Nr. 124/2015 “Për Eficiency e Energjisë”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

Auditimet energjetike të detyrueshme kryhen:

- b) çdo herë, përpara se një ndërtesë, objekt industrial dhe objektet e tjera që vlerësohen, vihen në punë dhe/ose ndërtohen nga e para apo i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm.

Ne nenin 17, pika 1 te Ligjit Nr. 124/2015 “Për Eficiency e Energjisë”, i ndryshuar, nder te tjera percaktohet se:

1. Auditimi energjetik, në kuptim të këtij ligji, kryhet nga auditues energjetikë të pavarur, të cilët certifikohen nga agjencia përgjegjëse për eficientë e energjisë dhe regjistrohen në regjistrin e saj elektronik.

Ne nenin 13 te Ligjit Nr. 37/2025 “Për performancën Energjetike të Ndërtesave”, nder te tjera percaktohet se:

1. Ndërtesat ose njësitë e ndërtesave, që i nënshtrohen një rinovimi të konsiderueshëm, plotësojnë të paktën kërkesat minimale të performancës energjetike...
2. Kur një element ndërtimi, që është pjesë e mbështjelljes së ndërtesës ose njësisë së ndërtesës dhe ka një ndikim të konsiderueshëm në performancën energjetike të mbështjellëses së ndërtesës, riparohet ose zëvendësohet, elementi i ndërtimit duhet të plotësojë kërkesat minimale të performancës energjetike për aq sa është teknikisht, funksionalisht e realizueshme dhe ekonomikisht në përputhje me nivelet e kostos optimale.

Ne nenin 15 te Ligjit Nr. 37/2025 “Për performancën Energjetike të Ndërtesave”, nder te tjera percaktohet se:

5. Certifikatat e performancës energjetike përfshijnë rekomandime për përmirësimin e performancës energjetike, në përputhje me nivelin e kostos optimale, reduktimin e emetimeve gjatë përdorimit tipik të ndërtesës dhe përmirësimin e cilësisë së ambientit të brendshëm.

14. Për ndërtesat në fazë projekti, certifikata paraprake e performancës energjetike është e vlefshme deri në përfundimin e punimeve dhe e humbet vlefshmërinë para fillimit të procesit të kolaudimit të ndërtesës.

Ne Vendimin Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesave”, nder te tjera percaktohet se:

3. Certifikata e përkohshme për performancën e energjisë për ndërtesën e projektuar paraqitet si pjesë e aplikimit për leje ndërtimi.

4. Certifikata përfundimtare për performancën e energjisë për ndërtesën lëshohet pas përfundimit të ndërtesës në përputhje me përdorimin tipik (standard) të ndërtesës dhe vlerën e përcaktuar Për ndërtesën e përfunduar, me qëllim marrjen e certifikatës së përdorimit të miratuar nga autoritetet shtetërore përgjegjëse, aplikanti paraqet raportin përfundimtar të auditimit të eficientë së energjisë, certifikatën përfundimtare të performancës, të lëshuar nga Audituesi Energjetik i Certifikuar dhe regjistruar pranë AEE-së, së bashku me “Deklaratën e përgjegjësisë profesionale”, nëpërmjet së cilës ai konfirmon dhe mban përgjegjësi për përputhshmërinë e projektit të përfunduar me legjislacionin në fuqi që përcakton kërkesat minimale për performancën e energjisë së ndërtesave.

Punonjës specialist për Testimin e Performancës së Produkteve te Ndërtimit është një kërkesë e në proporcion me natyrën dhe objektin e prokurimit për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e produkteve të ndërtimit. Ne nenin 8 te Ligjit Nr.8402, date 10.9.1998 “PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT”, i ndryshuar percaktohet se: Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. ***Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit, në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane.***

Ne nenin 9 te VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT nder te tjera, percaktohet: 1. Materialet dhe produktet e ndërtimit me standarde të detyrueshme vendosen në vepër kur janë shoqëruar me certifikatë cilësie, me rezultatet e provave dhe të analizave, që vërtetojnë ose

vlerësojnë përputhshmërinë e tyre me standardet, që referohen në përshkrimet dhe specifikimet teknike.

2. Materialet dhe produktet e ndërtimit, që përdoren në punimet e ndërtimit, duhet të jenë të reja, të papërdorura dhe pa defekte nga veprimet ose mosveprimet e zbatuesit të punimeve.

Ne nenin 11 të VKM nr. 448, datë 31.07.2025 “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZBATIMIT TË PUNIMEVE TËNDËRTIMIT DHE TË RREGULLAVE TË KANTIERIT ndër të tjera, përcaktohet:

4. Drejtuesi teknik i kantierit, për materialet me standarde të detyrueshme, merr kampione dhe njihet me rezultatet e testimit të tyre.

Testimi i performancës së produkteve të ndërtimit është një proces i rëndësishëm për të siguruar që materialet e përdorura në ndërtim përmbushin standardet e cilësisë dhe sigurisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të shmangur defekte strukturore dhe për të garantuar jetëgjatësinë e ndërtesave. Një certifikatë e tillë ndihmon në minimizimin e rreziqeve ligjore dhe financiare që mund të lindin nga përdorimi i produkteve të ndërtimit me cilësi të ulët. Ky kriter jo vetëm që është i arsyeshëm, por edhe i domosdoshëm për të siguruar që produktet e ndërtimit të jenë të testuara dhe të certifikuara sipas standardeve më të larta.

2.3.8 Operatori/et ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me licence nga Qendra Kombëtare e Licensimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme” sipas kodit 17 09 04 dhe 20 03 06 ose të këtyre kontratave shërbimi notoriale me shoqëri të pajisur me licencën e lartpërmendur. *Licenca duhet të shoqërohet me akt miratimin.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar; Ligjin Nr. 9010, datë 13.02.2003 “Për administrimin mjedisor të mbetjeve të ngurta”, i ndryshuar; VKM 402, Datë 30.6.2021 “Për Miratimin e Katalogut të Mbetjeve”; ligjin nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”; VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE”, i ndryshuar; ligjin nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimin nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.

Referuar Preventivit të Punimeve dhe specifikimeve teknike, ku ndër të tjera është parashikuar kryerja e punimeve të prishjes, gjenerohen mbetje të klasifikimit 17 09 04 (Mbetje të perzierra nga ndërtimi dhe të prishjeve) dhe mbetje të klasifikimit 20 03 06 (Mbetje nga pastrimi i ujërave të zeza).

Sa me sipër, kriteri për disponimin e licencës është i leshuar nga QKB me kodin III. 2. B është vendosur që AK të ketë sigurinë që operatori ekonomik që do të ofertojë të jetë i pajisur me licencën e mësipërme ose të ketë kontratë shërbimi me subjekte të licencuara me licencën e lartpërmendur, të lidhura me objektin e prokurimit, gjë e cila krijon bindjen dhe sigurinë të Autoritetit Kontraktor që ky Operator Ekonomik i zoteron kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës.

Ne nenin 77 te LPP nder te tjera parashikohet: Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Ne nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

Në nenin 5 të ligjit nr.10081 datë 23.02.2009 “Për Licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, parashikohet se “Ushtimi i veprimtarive dhe kryerja e veprimeve në territorin e Republikës së Shqipërisë janë, si rregull, të lira dhe nuk i nënshtrohen licencimit apo autorizimit, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj.”

Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis”, nënseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar parashikohet se: “Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

Ne nenin 1 te ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”, i ndryshuar percaktohet :

Ky ligj synon mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndotja dhe dëmtimi prej mbetjeve të ngurta, nëpërmjet administrimit mjedisor të tyre në çdo fazë, përfshi krijimin, grumbullimin, ndarjen, ruajtjen, transportin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin, të cilat çojnë në pakësimin e mbetjeve dhe zvogëlimin e ndikimeve të tyre të rrezikshme e të dëmshme

Ne nenin 2 te ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”, i ndryshuar percaktohet :

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

7. Mbetje të ndërtimit” janë mbetjet si: gurë, dhera, beton, tulla, që mbeten ngaveprimtaritë ndërtuese, rindërtuese, meremetuese dhe prishëse të ndërtesave dhe strukturave te tjera.

11. Prodhuesi i mbetjes” është personi fizik dhe juridik, veprimtaria e të cilit krijon mbetje.

13. “Zotëruesi i mbetjes” është personi fizik dhe juridik: a) veprimtaria e të cilit krijon këtë mbetje; b) i cili grumbullon, ruan përkohësisht, transporton dhe largon për në vendin e caktuar mbetje të ngurta; c) i cili përpunon dhe asgjëson mbetje të ngurta.

Ne nenin 3 te ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”, i ndryshuar percaktohet :

1. I nënshtrohen administrimit, sipas kërkesave të këtij ligji :

ç) mbetjet e ndërtimit;

3. Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, miraton “Katalogunshqiptar të klasifikimit të mbetjeve”, sipas “Katalogut europian të mbetjeve”.

Ne nenin 4 te ligjit Nr. 9010, date 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”, i ndryshuar percaktohet :

Detyrimeve të këtij ligji u nënshtrohen personat fizikë e juridikë, publikë dhe privatë, vendas ose të huaj: a) veprimtaritë e të cilëve krijojnë mbetje; b) kur janë zotërues të mbetjeve, të angazhuar dhe të licencuar për grumbullimin, depozitimin, transportimin, riciklimin, përpunimin dhe asgjësimin e tyre; c) organet shtetërore, organizatat shoqërore dhe shtetasit.

Ne nenin 38 te ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” percaktohet:

1. Transporti i mbetjeve jo të rrezikshme kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të licencuar sipas legjislacionit në fuqi...

Ne nenin 39 te ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” percaktohet:

1. Personat fizikë ose juridikë, të licencuar sipas legjislacionit në fuqi, që grumbullojnë ose transportojnë mbetje jo të rrezikshme, transferojnë mbetjet në impiante trajtimi të përshtatshme që plotësojnë kërkesat e këtij ligji.

Ne nenin 39 te ligjit nr. 57/2025 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” percaktohet:

1. Licencat për ushtrimin e veprimtarive në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve, të parashikuara në këtë ligj, jepen në zbatim të parashikimeve të legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

2. Grumbullimi, transportimi, ruajtja, riciklimi, përpunimi, asgjësimi, tregtimi apo ndërmjetësimi për mbetjet kryhen nga persona që disponojnë licencën për shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë.

3. Licenca për veprimtaritë e parashikuara në pikën 2 të këtij nenilëshohet në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në aktet nënligjore nga “Qendra Kombëtare e Biznesit”, pas miratimit të saj nga ministri.

Ne pikat 4, 5 dhe 6 te VKM Nr. 575, datë 24.6.2015 “PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE”, i ndryshuar percaktohet:

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107,

datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”. Termi “Zotërues i mbetjeve inerte”, në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17 të vendimit nr. 402, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut të mbetjeve.

5. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, qëndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t’i ruajë, t’i transportojë dhe t’i dorëzojë ato në lëndfill apo në venddepozitim të përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme”, si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme”.

6. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t’i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta.

Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit zotërojnë kapacitetin teknik e konkretisht licencë Kodi III.2.B “Për grumbullim, ruajtje dhe transportim i mbetjeve jo të rrezikshme”, ose të kete kontrate shërbimi noteriale me shoqëri të pajisur me licencën e lartpërmendur, ku të përfshihen ndër të tjera edhe **grumbullimi dhe transporti i mbetjeve që do të krijohen nga zërat e parashikuar të punimeve objekt prokurimi e në funksion të licencës.**

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të paraqesë :

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- SSH/EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 50001 (*Sistemi i menaxhimit të energjisë*) ose ekuivalent
- SSH/EN-ISO 3834-2 (*Kërkesat e cilësisë për saldimit me shkrirje të materialeve metalike*) ose ekuivalent

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i këtij bashkimi duhet të dorëzojë certifikata ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sa më sipër janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 dhe 2 ku citohet se: 1. “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të

konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”; 2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

- a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;
- b) efikasitetit të energjisë;
- c) sistemeve të menaxhimit mjedisor,

si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standardet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001 është standard ndërkombëtar, i cili parashton kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001 Objektivi kryesor i standardit është të përmirësojë vazhdimisht performancën e lidhur me energjinë dhe efikasitetin e energjisë dhe të identifikojë mundësitë e reduktimit të energjisë.

Eshtë një standard për projektimin, zbatimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të menaxhimit të energjisë. ISO 50001 ofron një kornizë më specifike që u mundëson organizatave të aplikojnë një fokus më të mprehtë për efikasitetin e energjisë. Mbështet organizatat në të gjithë sektorët që të përdorin energjinë në mënyrë më efektive përmes zhvillimit të një Sistemi të Menaxhimit të Energjisë. Standardi specifikon kërkesat për krijimin, zbatimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e një sistemi të menaxhimit të energjisë, qëllimi i të cilit është t’i mundësojë një organizatë të ndjekë një qasje sistematike në arritjen e përmirësimit të vazhdueshëm të performancës së energjisë, duke përfshirë efikasitetin e energjisë, sigurinë e energjisë, përdorimin e energjisë, dhe konsumin. **Kerkesa është vendosur në përputhje me Vendimin Nr. 537, datë 8.7.2020 “Për miratimin e kërkesave minimale të performancës së energjisë së ndërtesave dhe të elementëve të ndërtesave”. Duhet që godina në pyetje të pajiset me certifikatën performancës së energjisë, për këtë arsye do të duhet një monitorim hap pas hapi të gjithë elementeve të godinës dhe shtresave /mbeshtjellsave të saj, në mënyrë që të përmbushë qëllimin dhe godina të plotësojë klasifikimin minimal energjetik.**

ISO 3834-2 është një standard sistemi i përgatitur nga ISO për të përcaktuar kushtet e duhura të cilësisë bazuar në metodën e saldimit me shkrije të metaleve. Standarti i kualifikimit të prodhimit me burim ISO 3834-2 lidhet me cilësinë e produktit që mund të ndikohet nga saldimi dhe proceset e lidhura me saldimin. ISO 3834-2 është një standard udhëzues për përcaktimin e kushteve të cilësisë së kërkuara për prodhimin e salduar në fabrikë ose në terren. Përzgjedhja e gabuar e materialit ose kushtet e pafavorshme të saldimit mund të shkaktojnë çarje në nyjet e salduara. Për të siguruar prodhim të shëndoshë dhe efektiv, kompania duhet të dijë burimet e mundshme të problemeve dhe të zbatojë procedurat e duhura të cilësisë. Kërkesa për këto standart lidhet ngushtesisht me punimet, volumin dhe rendesine e tyre. Në projekt zbatim ndër të tjera, parashikohen punime të një rendesie të vecante, siç janë ato për përforcimin e strukturës (Përforcim i cernierës në kollonat dhe traret (pallat metalike, prizhonor, llac strukturor, material ngjites, bikomponent, saldim, skela; Veshje kornize në parapet me llmarine me lyerje me pjekje në furë (Ngjyre Kafë) dhe F.V Konstrukione metalike të perbera. Këto punime ndër të tjera parashikojnë edhe punime saldimi.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesë dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion të cilat janë si më poshtë vijon:

Nr	Lloji i mjeteve /pajisjeve	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 20 ton	Pronësi/Qira	copë	1
2	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 8-12 ton	Pronësi/Qira	copë	2
3	Eskavator me goma	Pronësi/Qira	copë	1
4	Çekiç pneumatik për eskavator	Pronësi/Qira	copë	1
5	Automjet vetshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5-5 ton	Pronësi/Qira	copë	2
6	Rrul vibrues hekur-gome me kapacitet 8-12 ton	Pronësi/Qira	copë	1
7	Eskavator me zinxhir	Pronësi/Qira	copë	1
8	Fadrome me goma	Pronësi/Qira	copë	1
9	Autobot uji	Pronësi/Qira	copë	1
10	Autobetoniere	Pronësi/Qira	copë	2
11	Autopompe Betoni	Pronësi/Qira	copë	1
12	Minidumper 4-6 ton	Pronësi/Qira	copë	1
13	Automjet me kosh	Pronësi/Qira	copë	1

14	Minifadrome	Pronësi/Qira	copë	1
15	Vinc kulle	Pronësi/Qira	copë	1
16	Pompë suvatimi	Pronësi/Qira	copë	2
17	Autovinc	Pronësi/Qira	copë	1
18	Minieskavator me goma	Pronësi/Qira	copë	1
19	Vibrator betoni	Pronësi/Qira	copë	2
20	Vibrator thellesie	Pronësi/Qira	copë	2
21	Gjenerator	Pronësi/Qira	copë	1
22	Autobetoniere 2-3.5 m3 vetengarkuese	Pronësi/Qira	copë	1
23	Skeleri	Pronësi/Qira	m ²	Min 1200
24	Betoniere kantieri	Pronësi/Qira	copë	2
25	Kontenier Stacioner (zyre ne objekt)	Pronësi/Qira	copë	1
26	Elektro argano	Pronësi/Qira	copë	2
27	ElektroSaldatriçe	Pronësi/Qira	copë	1
28	Gazogjen	Pronësi/Qira	copë	1
29	Matrapik	Pronësi/Qira	copë	2
30	Tranxh Hekuri	Pronësi/Qira	copë	1
31	Gershere hidraulike	Pronësi/Qira	copë	1
32	Total Station per rivlime matje/azhornime topografike	Pronësi/Qira	copë	1
33	Linje prodhim betoni	Pronësi/Qira/Kontrate furnizimi	cope	1

a) Për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), çertifikata e kontrollit teknik, siguracioni i mjetit, si dhe foto per secilin mjet te deklaruar ku te jete e dukshme dhe targa e mjetit.

Në rastin e mjeteve apo pajisjeve të tjera duhet të paraqiten aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes, si dhe foto për secilin mjet apo pajisje të deklaruar.

Për mjetet e siguruar me qira, dokumentet e mesipërme duhet të shoqërohen me kontratën noteriale perkatese të qirase, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

b) Për linjën e prodhimit të betonit, duhet të paraqesin dokumentacionin e pronësive/kontraten e qirase/kontraten e furnizimit. Në rast se fabrika është në pronësi/qira duhet të paraqitet edhe leja mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B.

Në rast se do të paraqitet kontrate furnizimi OE nuk detyrohet të paraqesë lejen mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B, por AK ka të drejtën e verifikimit nëse subjekti furnizues është apo jo i pajisur me leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B. Lidhja e një kontrate furnizimi me një subjekt, i cili nuk është i pajisur me leje mjedisore leshuar nga QKL Kodi III.1.B përben kusht për skualifikim.

Ky kriter do të përmbushet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit.

Dokumentacioni provues, që OE i disponon mjetet e mësipërme, do të dorëzohet nga operatori **ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.**

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/d të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Gjithashtu kriteri është vendosur referuar zerave të punimeve.

Në nenin 77 të LPP ndër të tjera parashikohet:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

Në nenin 39, pika 6/d), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

ç) mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën..

Për të përcaktuar numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM Nr.216, datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”.

Në mbështetje të dispozitës ligjore të sipërcituar Ligjvënësi i jep të drejtën Autoritetit Kontraktor të kërkojë nga ana e Operatorëve ekonomike **makinerite, mjetet dhe paisjet teknike**. Njësia e Prokurimit ka vlerësuar si të domosdoshëm paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me mjetet dhe paisjet teknike që Operatori ekonomik disponon në funksion të realizimit të kontratës objekt prokurimi.

Percaktimi i makinerive është bere referuar zërave të punimeve reflektuar në tabelë sa më poshtë:

Nr	Lloji i Makinerive	Proceset sipas preventivit	Sasia
1	Eskavator me zinxhir	Germim dheu me ekskavator zingjir, 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në toke	copë 1
2	Fadrome me goma	Shtytjen, grumbullimin, ngarkimin e materialeve dhe shtresave të dala nga prishja. Sipas preventivit kemi të bëjmë me një sasi të konsiderueshme të materialeve dhe shtresave që do të prishen çka e bën të nevojshëm përdorimin e një mjeti të tillë.	copë 1
3	Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës min 20 ton	Transport materiale ndërtimi të dala nga prishja që do të kryhen për rreth 8 ditë gjatë muajit të parë sipas grafikut Jane rreth 132 m ³ materiale (beton, mur tulle, suvatim) të dala nga prishja. Sipas llogaritjeve duhet 1 mjet 20 ton për të bërë transportin për 8 ditë sipas grafikut	copë 1
4	Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 8-12 ton	Transport materiale ndërtimi për punimet e shtresave (stabilizant, çakell) si dhe transportin e materialeve voluminoze dhe me peshe të konsiderueshme si hekur, tulla, konstruksione metalike, dritare, polisterol, shtylla metalike etj.	copë 2
5	Automjet vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -5 ton	Për transportin në kantier të materialeve të punës gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës.	copë 2
6	Eskavator me goma	Punimet e prishjes sipas preventivit: Prishje kollona, trare b/a; Prishje soleta b/a	cope 1
7	Çekiç pneumatik për eskavator	Punimet e prishjes sipas preventivit: Prishje kollona, trare b/a; Prishje soleta b/a	cope 1
8	Gershëre hidraulike	Punimet e prishjes sipas preventivit: Prishje kollona, trare b/a; Prishje soleta b/a (prerjen e hekurit)	Cope 1
9	Rrul vibrues hekur-gome me kapacitet 8-12 ton	Për cilindrimin e çakellit dhe stabilizantit sipas preventivit: Shtrese stabilizant t=10cm; Mbushje me çakell e gur gurore në trupin e rruges, përhapur e ngjeshur me makineri	cope 1

10	Minieskavator me goma	Per germimet ne hapësira te ngushta sipas proceseve te punes te parashikuara ne preventiv: Ndertim drenazhi me gjeotekstil 50x120cm	copë 1
11	Autobetoniere (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 mjete te tille per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates duke pasur parasysh natyren e procesit te punes, sasine e prodhimit te nje auto betoniere, grafikun dhe volumin sipas preventivit.	Prodhim dhe transport betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit	copë 2
12	Autobot uji	Per furnizimin me uje te kantierit per procese te ndryshme gjate punes	copë 1
13	Automjet me kosh	Hidroizolim taracash, ngjitje punonjesish dhe materialesh, punime ullqesh, F.V Ndricues ne ambientet e jashtme etj, sipas zerave te preventivit	copë 1
14	Autopompe betoni	Hedhja e betonit sipas proceseve te punes te parashikuara ne preventive: Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m	copë 1
15	Pompe suvatimi (AK ka vendosur te kerkoje minimalisht 2 pajisje te tilla per te garantuar zbatimin me sukses te kontrates. Numri eshte ne proporcion me volumin e punimeve te parashikuara ne preventive dhe grafikun e punimeve)	Per punimet e suvatimit sipas preventivit	copë 2
16	Autovinç	Ngritjen, uljen dhe zhvendosjen e materialeve, te cilat kane peshe te kosiderueshme si tulla, konstruksione metalike, llac, panele, rezervuar etj.	copë 1
17	Vibrator thellesie	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m; Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m; Pusete shkarkimi 80 x 80, h = 100 cm; Pusete shiu 40 x 60, h = 100 cm, me kapak gize	copë 2
18	Minidumper 4-6 ton	Per levizjen e materialeve te renda (rere, tulla, pllaka, etj) brenda kantierit ne hapësira te ngushta.	copë 1
19	Minifadrome	Shtytjen, grumbullimin, ngarkimin e materialeve dhe shtresave te dala nga prishja qe krijohen ne hapësira te ngushta Perhapja e materialeve tek punimet e shtresave sipas preventivit.	copë 1

20	Vinç kulle	Per punimet e ndryshme, transport materialesh te renda dhe volumineze ne lartesi ne ambjentet e jashtme sipas preventivit: f.v hekur, beton, llaç, cemento, tulla etj	cope 1
21	Vibrator betoni	Vibrim betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit: Shtrese betoni C 7/10; Shtrese betoni C 16/20;	cope 2:
22	Skeleri (Sasia eshte kerkuar duke pasur parasysh siperfaqen e fasades se godines)	Per punimet e ndryshme ne ambjentet e jashtme si suvatime, veshje me polisterol, lyerje me boje etj	1200 m2
23	Autobetoniere 2-3.5 m3 vetengarkuese	Transport betoni sipas proceseve dhe markave te ndryshme pjese e preventivit. Duke qene se kemi te bejme me nje investim ne zona urbane ku ka dhe hapësira te ngushta eshte kerkuar ky mjet me kapacitet 2-3.5 m3 per transportin dhe hedhjen e betonit ne hapësirat e ngushta.	cope 1
24	Matrapik	Per punimet e prishjes sipas preventivit	cope 2
25	ElektroSaldatriçe	Per punimet e saldimit: F V konstruksione metalike te perbera; F.V. Konstruksione metalike (suporte mbeshtetes, dado, vida etj); Perforcim i cernieres ne kollonat dhe traret (pllaka metalike, prizhonier, llac strukturor, material ngjites, bikomponent, saldim, skela); Veshje kornize ne parapet me llamarine me lyerje me pjekje ne furre (Ngjyre Kafe)	cope 1
26	Betoniere kantieri	Per prodhim llaçi per suvatim	cope 2
27	Gjenerator	Furnizimin me energji te pajisjeve te ndryshme gjate proceseve te punes	copë 1
28	Gazogjen	Per punimet sipas preventivit: F V konstruksione metalike te perbera; F.V. Konstruksione metalike; Perforcim i cernieres ne kollonat dhe traret (pllaka metalike, prizhonier, llac strukturor, material ngjites, bikomponent, saldim, skela); Veshje kornize ne parapet me llamarine me lyerje me pjekje ne furre (Ngjyre Kafe)	cope1
29	Total Station per rlevime matje/azhornime topografike	Per punimet topogjeodezike sipas projektit	copë 1
30	Elktro argano	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva; Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama	cope 2

31	Tranxh hekuri	Per prerjen dhe kthimin e hekurit F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm	cope 1
32	Linje prodhim betoni. Kerkesa eshte ne propocion me volumin e kontrates. Punimet e betonit jane nje nga zerat me te rendesishem te punimeve, si edhe duke qene nje nga zerat me sasine dhe vleren me te madhe financiare.	Per furnizim me beton sipas preventivit.	cope 1

2.3.11 Operatori Ekonomik të ketë laborator testimi ose kontratë noteriale me një laborator testimi ku laboratori të ketë të akredituara këto teste SSHEN 12390-3:2019 ASTM C39/C39M, SSH EN 1744-1:2009+A1:2012 ose ekuivalentet.

Argumentim: Kërkesa e përcaktuar sa më sipër është vendosur në mbështetje të nenit 39, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar; Ligjit Nr.8402, DATE 10.9.1998 “PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT”, i ndryshuar.

Ne nenin 14 te ligjit Nr.8402, DATE 10.9.1998 “PER KONTROLLIN DHE DISIPLINIMIN E PUNIMEVE TE NDERTIMIT”, i ndryshuar percaktohet se :

Materialet e ndërtimit të importit duhet të jenë të shoqëruara me certifikatën e cilësisë nga një laborator i akredituar nga vendet e Bashkimit Europian. Në rastet kur këto materiale janë prodhuar në vend, duhet të pajisen me certifikatë cilësie nga laboratorët e akredituar nga Drejtoria e Standardeve dhe e Cilësisë.

Kërkesa per piken e mesiperme eshte bere pasi referuar volumit te madh te betonit, i cili do te hidhet ne veper eshte i domosdoshem kontrolli periodik dhe testimi i betonit per te garantuar cilesine ne perputhje me specifikimet teknike. Pasi eshte prodhuar betoni, ai duhet kontrolluar nese i ploteson kriteret sipas kerkesave te projektit. Mbasi te prodhohet ai dhe para hedhjes se tij, duhet marre nje kampion betoni per te bere testime ne laborator dhe rezultatet e laboratorit duhet te dorezohen tek Supervizori.

2.3.12 Per produktin bojë hidroplastike për lyerjen e godinave, ambienteve të brendshme dhe të jashtme, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtare te tyre per furnizimin me produktin e mesiperm gjate zbatimit te kontrates, shoqëruar me SSH/EN ISO 9001:2015, SSH/EN ISO 14001:2015, katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të perdoren, si dhe raport analizimi për bojë lyerje muri, lëshuar nga inspektoriat shtetëror teknik dhe industrial ose institucione të tjera të akredituara. Ne rastin e kontrates me distributorin te dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar se operatori ekonomik do të sigurojë produktet e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike. Kërkesa për këto produkte është në proporcion me rëndësinë, sasinë dhe vlerën financiare që këto produkte zënë në preventiv.

2.3.13 Për materialet/produktet: hekur, materiale hidroizolimi (katrama), polisterol, dyer dhe dritare d/alumini, pajisjet ngrohje ftohje (Fan Coil), panelet fotovoltaike, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontrate noteriale furnizimi me prodhuesin/t ose distributorin/ët zyrtarë të tyre për furnizimin me materialet e mesiperme gjatë zbatimit të kontratës, Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve, ku të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të përdoren dhe të jenë paraqitur dhe markuar të dhënat teknike për mallrat objekt prokurimi. Në rastin e kontratës me distributorin të dokumentohet lidhja e tij me prodhuesin.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar: Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar se operatori ekonomik do të sigurojë produktet e kërkuara në përputhje me specifikimet teknike. Kërkesa për këto produkte është në proporcion me rëndësinë, sasinë dhe vlerën financiare që këto produkte zënë në preventiv.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet Teknike për procedurën respektive janë hartuar nga drejtoria e projekteve, pjesë e perberesë së strukturës së Bashkisë Elbasan, që ka hartuar edhe projektin përkatës të zbatimit duke qenë elemente të perberesës së tij. Në hartimin e tyre janë marrë në konsideratë kërkesat ligjore të fushës së planifikimit dhe zhvillimit të territorit si dhe normat përkatëse të Ligjit nr. 9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendimi i KM nr. 312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kërkesat e ligjit të Ligjit Nr. 10480 datë 17.11.2011, “Për sigurinë e përgjithshme të produkteve joushqimore”.

Kudo tek specifikimet apo relacionet teknike bashkelidhur në SPE ku janë kërkuar standardet UNI/DIN/EN/ISO do të pranohen edhe standardet SSH/ UNI/DIN/EN/ISO.

Specifikimet Teknike janë pjesë e setit të dokumentave të ngarkuara në SPE për procedurën respektive.

Fondi Limit i perlllogaritur për këtë procedurë është hartuar në bazë të VKM nr 629 datë 15.07.2015 ‘‘Për Miratimin e Manualeve Teknike të Cmimeve të Ndërtimit dhe analizat teknike të tyre’’,

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo

kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.